



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 120/2018

**PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS SË KRYETARIT TË GRUPIT
PARLAMENTAR TË PARTISË “LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM”
PËR NDRYSHIM TË RENDIT TË DITËS NË SEANCË PLENARE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Mosmiratimin e kërkesës së Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim” për të shqyrtuar në seancën plenare të datës 13.12.2018 projektligjet e mëposhtme:

- a) projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- b) projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 13.12.2018